

VENDIM
Nr. 886, datë 27.12.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 34, DATË 19.1.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE, PËR VITIN 2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tabela nr. 1 “Plani i të ardhura-shpenzimeve, për vitin 2022, për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”, bashkëlidhur vendimit nr. 34, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr. 1

**PLANI I RISHIKUAR TË ARDHURA - SHPENZIME PËR VITIN 2022 PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE**

000/lekë

Të ardhurat		Shpenzimet	
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	135.000	Shpenzime personeli	37,300
Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim	5.100	Shpenzime operative dhe korrente	21,240
Marrëveshja e Madridit	70.000	Transferta korrente e jashtme	20.000
Marrëveshja e Hagës	1.100	Shpenzime kapitale	105.100
Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP	250	Totali i shpenzimeve	183,640
		Tëprica derdhje në buxhetin e shtetit	27,810
Totali i të ardhurave	211.450	Totali i shpenzimeve dhe tëpricave në buxhetin e shtetit	211.450